



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "THOMA PAPAPANO" GJIROKASTËR

Nr. 273 Prot.

Gjirokastër, më: 26.09.2022

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune

Drejtuar: Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit", si dhe Udhëzimin nr. 28, datë 14.10.2019, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Normat e Punës Mësimore në Institucionet e Arsimit Profesional".

Shkolla Mesme Profesionale : "Thoma Papapano", Gjirokastër, ju njofton për krijimin e një vend të lirë pune, në pozicionin e mësuesit të praktikës profesionale, drejtimi mësimor Termohidraulikë.

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;



e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2..Aplikanti duhet të plotësojë si kritere të posaçme si vijon:

a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë ose të përafërt me kualifikimin / kualifikimet profesionale të ofruesitë AFP-së, për të cilin po aplikon;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;

- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021.

- Kartën e identitetit;

- Diplomën;

- Librezën e punës;

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV:

- Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

-Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore:

- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij ,nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

-të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentacionet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda dates 7/10/2022.

Drejtori

Renata Puleri

